



Planuar / Dorezuar Prijemno/Prudato Received/Delivery	04.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHEK	1183/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.93/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.93/2022 të datës 04.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me në Komunën e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04/03/2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.93/2022 e datës 04.02.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, ankuesit t'i bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-babait, në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datë 03.01.2013 në pozitën “Zyrtar për Integritim Evropian” në Komunën e Obiliqit, me datë 10.06.2021 ka paraqitur kërkesë për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së babait tek Drejtori e Administratës e Komunës së Obiliqit. Drejtorja e Administratës së Përgjithshme të Komunës së Obiliqit më datë 15.06.2021 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij duke e njoftuar që: *“si institucion bëjmë vetëm pagesën e shërbimeve të varrimit për çdo qytetar të Komunës sonë”*.

Ankuesi kundër kësaj përgjigje të cilën në bazë të emailit të datës 15.02.2022 të Zyrtares së Personelit të Komunës së Obiliqit e cila ka potencuar që: *“Ju njoftoj se lidhur me shkresën në fjalë Arkiva e komunës nuk ka kurrfarë dëshmi se zyrtar në fjalë ka pranuar shkresën me shkrim në kohën kur është kthyer përgjigja. Zyrtar në fjalë shkresën e ka marrë më datë 28.01.2022”*.

Ankuesi, fizikisht më datë 04.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:529/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore që organi i punësimit Komuna e Obiliqit ti bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes (babait).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 11.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli me datë 14.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 732/2022, s2 bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.93/2022 të datës 04.02.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin e datës 02.02.2022; Kërkesën e datës 10.06.2021 të ankuesit për Drejtorin e Administratës; Përgjigjen e datës 15.06.2021 nga Drejtorja e Administratës së Përgjithshme; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civil e datës 24.08.2020; Certifikatën e vdekjes e datës 28.08.2020; Akt Emërimit e datës 03.01.2013; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.02.2022; Vendimin e datës 26.02.2014 të Kuvendit Komunal të Obiliqit; Përgjigjen e datës 15.02.2022 të Zyrtares së Personelit të Komunës së Obiliqit; Kërkesën e datës 23.02.2022 për _____ dhe përgjigjen e të njëjtës datë; Përgjigjen e datës 28.02.2022; Dëshmi për pranim e datës 28.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, t’i bëhet kompensimi në rastin e vdekjes së babait të tij.

Bazuar në përgjigjen e datës 15.02.2022 të Zyrtares së Personelit të Komunë së Obiliqit e cila dëshmon se: *"Ju njoftoj se lidhur me shkresën në fjalë Arkiva e komunës nuk ka kurrfarë dëshmi se zyrtar në fjalë ka pranuar shkresën me shkrim në kohën kur është kthyer përgjigja. Zyrtar në fjalë shkresën e ka marrë më datë 28.01.2022, po ashtu më datë 23.02.2022 kemi kërkuar përgjigje nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Obiliqit, se a qëndron përgjigja e Zyrës së Personelit, ndërsa e njëjta më datë 23.02.2022 është përgjigjur se: "...zyrtari sic ju kane njoftuar edhe zyra e personelit, zyrtarisht e ka pranuar shkresën me datën 28.01.2022. Deri te kjo ngjarje ka ardhur për arsyeje se pas ndërrimit te jetës te zyrtarit te arkives nga pandemia Covid19 me datën 14 prill 2021, punën e zyrtarit e arkives e kane kryer zyrtaret te cilët i kemi angazhuar me autorizim te cilët nuk kane qene ne nivelin e punës", ndërsa më datë 28.02.2022 ka dërguar dëshminë për pranim, atëherë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstatoi se meqë kërkesa respektivisht ankesa e ankuesit ka të bëjë me para atëherë në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", është e pranueshme.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 22, ku përcaktohet se: 2. *Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ...2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku parashihet se: ...2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe ka konstatuar që me rastin e vdekjes se anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.*

Se kush përbënë familjen, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i'u referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *"Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji".* Lidhur me këtë, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes se anëtarit të familjes.

Mbi këtë bazë, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10349945 të datës 28.08.2020, konstatohet se babai i ankuesit ka ndërruar jetë me datë 09.08.2020, ndërsa sipas Vërtetimit me Nr. 10 të datës 02.02.2022 të lëshuar nga Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Obiliqit, vërtetohet se ankuesi ka jetuar në bashkësi familjare më babain e tij deri në momentin e vdekjes, kështu që duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë



dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së babait është i bazuar, andaj Komuna e Obiliqit në kuptim të këtyre dispozitave është e obliguar që ankuesit t'i bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-babait, në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.93/2022, datë 04/03/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së